

**VENDIM**  
**Nr. 561, datë 29.9.2018**

**PËR PAJISJEN ME TEKSTE SHKOLLORE TË NXËNËSVE, FORMIMIN FILLESTAR, ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM PROFESIONAL TË MËSUESVE, si dhe PËR KRIJIMIN E FUNKSIONIMIT E KLASAVE NË GJUHËN E PAKICAVE KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Nxënësve të arsimit bazë të pakicave kombëtare, të cilët mësojnë dhe/ose mësohen në gjuhën e pakicës kombëtare, u sigurohen tekstet shkollore falas.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin bashkë-rendon punën me institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore dhe shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit, për nevojat e formimit fillestar për mësues që do të zhvillojnë mësim në gjuhën e pakicave kombëtare.

3. Trajnimi dhe zhvillimi profesional i mësuesve që zhvillojnë mësim në gjuhën e pakicave kombëtare financohet me fondet e buxhetit të shtetit. Mësuesit trajnohen, të paktën 3 (tri) ditë në vit, me programe trajnimi të akredituara. Njësitë arsimore vendore organizojnë, koordinojnë dhe mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në nivel institucioni arsimor. Procedurat e trajnimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve në nivel institucioni arsimor përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Nisma për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga:

- a) Njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse;
- b) Njësia arsimore vendore përkatëse;
- c) Komuniteti i zonës, ku pritet të hapen klasa të pakicave kombëtare.

5. Për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare, kryetari i bashkisë dhe titullari i njësisë përkatëse arsimore vendore, pas konsultimit me përfaqësues të pakicave kombëtare, i paraqesin propozimin përkatës ministrit përgjegjës për arsimin.

6. Propozimi për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare në institucionet arsimore parauniversitare publike shoqërohet me studimin mbi argumentimin e domosdoshmërisë së hapjes së klasave me nxënës të pakicave kombëtare, si dhe me kontributin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

7. Propozimi për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare paraqitet jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para fillimit të vitit mësimor.

8. Klasat në gjuhën e pakicave kombëtare hapen kur plotësohen kriteret si më poshtë vijojnë:

a) Ndërtesa e institucionit arsimor dhe mjediset e saj të plotësojnë standardet sipas legjislacionit në fuqi;

b) Institucioni arsimor të jetë i pajisur me mjete mësimore për funksionimin normal të procesit mësimor;

c) Numri i nxënësve të pakicave kombëtare të jetë jo më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës për klasë;

ç) Personeli mësimor i klasave me nxënës të pakicave kombëtare plotëson kriteret profesionale dhe është emëruar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

9. Në kushte të veçanta, kur numri i fëmijëve apo i nxënësve të pakicave kombëtare është më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës për klasë, funksionimi i klasave në gjuhën amtare të pakicës kombëtare bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Efektet financiare për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën e pakicave kombëtare të parashikohen në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

11. Nisma për mbylljen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga:

- a) Ministri përgjegjës për arsimin;
- b) Njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse;
- c) Njësia arsimore vendore përkatëse.

12. Kryetari i bashkisë dhe titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse, në rastet kur institucioni arsimor nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi, i paraqesin ministrit përgjegjës për arsimin propozimin për mbylljen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare në institucionin arsimor publik, pas konsultimit me përfaqësues të komunitetit të pakicës kombëtare, ku ndodhet institucioni arsimor publik.

13. Hapja dhe mbyllja e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

14. E drejta për arsim në gjuhën e pakicës kombëtare nuk duhet të cenojë mësimin e gjuhës shqipe.

15. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**